



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK, BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2112 prot

Korçë, më 28 / 12 / 2020

VENDIM

Nr. 693, datë 28.12.2020

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË AKADEMIKE,
KËRKIMORE-SHKENCORE DHE FINANCIARE PËR VITIN AKADEMIK
2019-2020

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, "Funksionet e Senatit Akademik", pika 1, gërma g, si dhe neni 49, "Funksionet e Bordit të Administrimit në Institucionet e arsimit të lartë", pika 1, gërma h, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, pasi diskutuan mbi raportin vjetor të veprimtarisë të institucionit për vitin akademik 2019-2020, të hartuar nga Rektorati i Universitetit si dhe duke u bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr 5, datë 19.02.2018, "Për përcaktimin e elementëve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", pika 4, në mbledhjen e përbashkët të datës 28.12.2020

VENDOSËN:

1. Të miratojnë raportin vjetor të veprimtarisë akademike, kërkimore-shkencore dhe financiare të vitit akademik 2019-2020, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
Prof.as.dr. Mamica Nene



KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK**

Nr. 2113 prot

Korçë, më 28 / 12 / 2020

VENDIM

Nr. 694, datë 28.12.2020

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË ORGANIGRAMËN E UNIVERSITETIT
"FAN S. NOLI", KORÇË PËR VITIN 2021, ME RELACIONIN PËRKATËS**

Mbështetur në ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma ç, si dhe në udhëzimin e Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr.27, datë 29.12.2017, "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.12.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në organigramën e Universitetit për vitin 2021, së bashku me relacionin përkatës, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK**

Nr. 2114 prot.

Korçë, më 28. 12. 2020

VENDIM

Nr. 695, datë 28. 12. 2020

PËR

**PËRCAKTIMIN E AFATIT TË RREGJISTRIMIT DHE PËRFUNDIMIT TË
DOKTORATAVE**

Nisur nga situata e veçantë e krijuar nga pandemia e Covid-19, si dhe nga fakti që prej vitit akademik 2013-2014 janë pezulluar programet e doktoraturës në universitetet publike të vendit, Senati Akademik, mbasi shqyrtoi problematikën e krijuar me një numër të caktuar të personelit akademik me kohë të plotë, të kategorisë “Asistent-lektorë”, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 126, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”

VENDOSI:

1. Të shtyjë afatin e përfundimit të studimeve të doktoratave, për personelin akademik me kohë të plotë që janë në proces, deri në datën 30 qershor 2021.
2. Të shtyjë afatin për rregjistrim në programet e doktoraturës, të personelit akademik me kohë të plotë, që nuk është rregjistruar ende, deri në datën 30 tetor 2021.
3. Për personelin akademik të kategorisë “Asistent-lektorë” që përmendet më lart, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit të lidhë kontratat e punës me afat të caktuar sipas përcaktimeve të bëra përkatësisht në pikën 1 dhe pikën 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT
REKTORI**

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2027 prot

Korçë, më 11 / 12 / 2020

VENDIM

Nr. 667, datë 11.12.2020

PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT
ME "UBT", PRISHTINË,
"MASTER SHKENCOR" NË "TË NXËNËT, EDUKIMI DHE TEKNOLOGJIA"

Në zbatim të nenit 38 dhe nenit 75 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit nr. 1 datë 14.01.2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" dhe të nenit 11 të Statutit të UNIKO duke u nisur nga propozimet e Departamentit të Edukimit dhe Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, vendimet e autoriteteve dhe organeve drejtuese përgjegjëse të institucionit partner "UBT", Prishtinë, Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli", në komunikim e përbashkët online të datës 11.12.2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e njësisë bazë dhe të dekanatit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë për hapjen e programit të ciklit të dytë, "Master Shkencor" në "Të nxënët, Edukimi dhe Teknologjia" si program i përbashkët me "UBT", Prishtinë.
2. Grupi i punës dhe Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor ngarkohen me zbatimin e procedurave të aplikimit në portalin zyrtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2028 prot

Korçë, më 11 / 12 / 2020

VENDIM

Nr. 668, datë 11.12.2020

PËR

REALIZIMIN E NGARKESËS TË ORËVE JASHTË AUDITORIT PËR VITIN
AKADEMIK 2019-2020

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, kreu II pika 1, Senati Akademik në diskutimin online të datës 11.12.2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë realizimin e ngarkesës orë jashtë auditorit për vitin akademik 2019-2020, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORË GJITHSEJ JASHTË AUDITORIT	ORË TË PAGUESHME JASHTË AUDITORIT DERI NË 100 ORË	Pagesa bruto 100%	Orët e pagueshme 75 %	Pagesa Bruto
12586	11165	10,128,360	8,374	7,573,996

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1849 prot

Korçë, më 13 / 11 / 2020

VENDIM

Nr. 631, datë 13 . 11 . 2020

PËR

**PËRSHTATJEN E KUOTAVE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT
TË DYTË MASTER**


Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe VKM nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të", i ndryshuar, pika 2.7 gërma b) "Në varësi të ecurisë së regjistrimeve, kapaciteti i kuotave të programeve mund të përshtatet nga IAL-të në përputhje me interesin e studentëve, për programet e të njëjtit cikël studimi, që ofrohen nga njësitë bazë të së njëjtës njësi kryesore, duke mos tejkaluar, në asnjë rast, totalin e kapacitetit të deklaruar të kuotave, të përcaktuar në nivel njësie kryesore", Senati Akademik në diskutimin online,

VENDOSI:

- 1- Rishpërndarjen e kuotave mbështetur në totalin e kuotave të deklaruar nga njësitë kryesore, për programet e studimit si më poshtë:
- 2- Në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë:
 - a) Për programin e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional", "Mësues për arsimin fillor", shtohen 5 kuota mbi kuotat e deklaruar, të cilat i zbriten kuotave të programit të studimit "Master Profesional" në "Mësues për arsimin e mesëm profesional".
 - b) Për programin e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional", "Mësues i Gjuhës Angleze", shtohen 5 kuota mbi kuotat e deklaruar, të cilat i zbriten kuotave të programit të studimit "Master Profesional" në "Mësues për arsimin e mesëm profesional".
- 3- Në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane:
 - a) Për programin e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në "Mësues në Matematikë dhe Informatikë-Fizikë", shtohen edhe 5 kuota mbi kuotat e deklaruar, të cilat i zbriten kuotave të programit të studimit "Master Profesional" në "Administrim Publik".

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1753 prot

Korçë, më 29 / 10 / 2020

VENDIM

Nr. 600, datë 29.10.2020

PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PARAPRAKE MBI ZHVILLIMIN E
PROCESIT TË MËSIMDHËNIES, PRANISË SË STUDENTËVE DHE
PERSONELIT NË UNIVERSITETIN "FAN S. NOLI", PËR VITIN AKADEMIK
2020-2021

Mbështetur në urdhrin Nr. 293 prot, datë 29.09.2020, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për caktimin e datës së fillimit të vitit akademik 2020-2021", të urdhërit Nr. 289 prot, datë 04.05.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për miratimin e udhëzuesit "Për masat ndaj Covid-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore"", të Aktit Normativ nr.3, datë 15.3.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19", i ndryshuar, të miratuar me ligj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si dhe në vijim të përvojës së krijuar nga zbatimi i Planveprimit për përfundimin e vitit akademik 2019-2020 në Universitetin "Fan S. Noli", me propozim të Rektoratit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.10.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e "Planit të masave paraprake mbi zhvillim e procesit të mësimdhënies, pranisë së studentëve dhe personelit të Universitetit "Fan S. Noli" për vitin akademik 2020-2021, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello

Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1754 prot

Korçë, më 29 / 10 / 2020

VENDIM

Nr. 601, datë 29.10.2020

PËR

MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN MBI "MASAT
SANITARE PËR MINIMIZIMIN E RISKUT NGA COVID-19", NË
UNIVERSITETIN "FAN S. NOLI", KORÇË

Mbështetur në Ligjin nr 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1, gërma d), si dhe në Statutin e Universitetit neni 11, pika 6, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 29.10.2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në Rregulloren mbi "Masat sanitare për minimizimin e riskut nga Covid-19" në Universitetin "Fan S. Noli", Korçë, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1755 prot

Korçë, më 29 / 10 / 2020

VENDIM

Nr. 602, datë 29.10.2020

PËR

MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT AKADEMIK 2020-2021

Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1, gërma ç, si dhe në urdhrin Nr. 293 prot, datë 29.09.2020, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për caktimin e datës së fillimit të vitit akademik 2020-2021", Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.10.2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë strukturën e vitit akademik 2020-2021, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1756 prot

Korçë, më 29 / 10 / 2020

VENDIM

Nr. 603, datë 29.10.2020

PËR

MIRATIMIN E PROPORZIMEVE TË FAKULTETEVE PËR NDRYSHIMET
NË PLANET MËSIMORE NË PROGRAMET E STUDIMIT BACHELOR PËR
VITIN AKADEMIK 2020-2023, NË PROGRAMET MASTER PËR VITIN
AKADEMIK 2020-2021 DHE 2020-2022 SI DHE PËR PROGRAMET 2-
VJEÇARE PËR VITIN AKADEMIK 2020-2022

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1 gërma dh), në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë neni 11 pika 9, si dhe në Rregulloren e organizmit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore të Universitetit, neni 7 pika 16, Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.10.2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimet për ndryshime në planet mësimore të fakulteteve, në programet e studimit "Bachelor" për vitin akademik 2020-2023, në programet "Master" për vitin akademik 2020-2021 dhe 2020-2022 si dhe për programet 2-vjeçare për vitin akademik 2020-2022 sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1457 prot

Korçë, më 29 / 10 / 2020

VENDIM

Nr. 604, datë 29.10.2020

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
MASTER PROFESIONAL NË "MARKETINGU DIGJITAL"**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 42 pika 7, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të MASR, Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.10.2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për hapjen e programit të studimit Master Profesional në "Marketingu Digjital", për departamentin Marketing-Turizëm, për vitin akademik 2021-2022.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof.dr. Dhimitri Bello**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1456 prot

Korçë, më 29 / 09 / 2020

VENDIM

Nr. 491, datë 29.09.2020

PËR

**MIRATIMIN E TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR ÇDO
PROGRAM STUDIMI PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021**

Mbështetur, në VKM nr. 288, datë 21.05.2018 për "Miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", në VKM nr. 866, datë 23.10.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.638, datë 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si dhe tarifën e shkollimit për vitin akademik 2015-2016", si dhe në VKM nr. 778, datë 26.12.2018, "Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar, pika 1 gërma a), Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.09.2019,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e tarifave të shkollimit për vitin akademik 2020-2021 për programet e ciklit të parë, për programet e ciklit të dytë dhe programet profesionale të studimit të njëjta me vitin akademik 2019-2020, përveç programeve të ciklit të parë bachelor, të fakultetit të Bujqësisë që ndryshojnë si: Menaxhim Agrobizenesi 15.000 lekë, Inxhinieri Agronomike 15.000 lekë dhe Mjekësi e Bimëve dhe Hortikulturë 20.000 lekë. Kemi dhe tarifën

e programit të ri të studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Arsim Special për Gjithëpërfshirjen” me vlerën 30.000 lekë për semestër.

2. T’i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e tarifave të regjistrimit paraprak 1,600 lekë për të gjitha programet e studimit Bachelor dhe programet profesionale, 2,500 lekë për të gjitha programet e studimit Master, dhe 3,000 lekë për të gjitha programet e dyta të studimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof.dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1454 prot

Korçë, më 29/09/2020

VENDIM

Nr. 492, datë 29.09.2020

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË
"MËSUESI NË ARSIM SPECIAL PËR GJITHËPËRFSHIRJEN"**

Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, nr. 80/2015, neni 25, pika 7, Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve, i ndryshuar", si dhe në vendimin e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë nr. 478, datë 25.09.2020, Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.9.2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për hapjen e programit të ri të studimit "Master Profesional" në "Mësuesi në Arsim Special për Gjithëpërfshirjen" ofruar në 1 vit akademik me 60 kredite, nga departamenti i Edukimit për vitin akademik 2021-2022.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof.dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1458 Prot.

Korçë, më 29.09.2020

VENDIM

Nr. 493, datë 29.09.2020

PËR

**NJË SHITESË NË RREGULLOREN E SENATIT AKADEMIK
TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË**

Senati Akademik, i mbledhur në datën 29/09/2020, pasi u njoh me përmbajtjen dhe diskutoi në lidhje me një shtesë në rregulloren e tij të funksionimit, bazuar në ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, germa d, në Statutin e Universitetit, nenet 10, pika 8 dhe 11, pika 6, si dhe në Rregulloren e Senatit Akademik të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 15,

VENDOSI:

1. Në Rregulloren e Senatit Akademik të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, pas nenit 14, të shtohet neni 14/1 me titull "*Shpërblimi mujor për anëtarët e Senatit akademik*" dhe me përmbajtje si vijon:

14/1. "Shpërblimi mujor për anëtarët e Senatit akademik"

1. Shpërblimi mujor për anëtarët e Senatit Akademik është në masën 25 000 lekë në muaj, sipas VKM nr. 656, datë 31.10.2018, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore", pika 5, dhe Vendimit nr. 742, datë 06.12.2018, të Bordit të Administrimit të Universitetit.
2. Në rast mungese në mbledhjen e zhvilluar sipas përcaktimeve të secilës pikë, të nenit 7 "Mbledhja e Senatit Akademik", të kësaj rregulloreje, anëtari i Senatit Akademik nuk e përfiton shpërblimin mujor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. Dr. Dhimitri Bello





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1356 prot

Korçë, më 18 / 09 / 2020

VENDIM

Nr. 439, datë 18.09.2020

PËR

SHTIMIN E DATAVE TË SEZONIT TË PROVIMEVE TË MBARTURA NË
STRUKTURËN E VITIT AKADEMIK 2019-2020

Mbështetur në propozimin e Rektoratit, Nr. 1222 prot, datë 04.09.2020, "Për shtimin e datave të sezonit të provimeve të mbartura në strukturën e vitit akademik 2019-2020", si dhe në vendimin e Senatit, Nr. 226, datë 14.05.2020, "Për miratimin e disa ndryshimeve në strukturën e vitit akademik 2019-2020" në Universitetin "Fan S. Noli", Korçë, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 18.9.2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë një ndryshim në strukturën e vitit akademik 2019-2020, ku periudha **21 tetor deri më 30 tetor 2020**, do të jetë sezoni i provimeve të mbartura, (që zëvendësojnë vjeshtën), për studentët e viteve të para të programeve 2-vjeçare me karakter profesional, për studentët e viteve të para dhe të dyta bachelor si dhe për studentët e viteve të para master (2-vjeçar).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

REKTORI

Prof. dr. Dhimitri Bello





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1194 prot

Korçë, më 31 / 08 / 2020

VENDIM

Nr. 392, datë 31.08.2020

PËR

**EMËRIMIN E NËNKRYETARIT TË SENATIT AKADEMIK TË
UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË**

Mbështetur në Rregulloren e Senatit Akademik të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë,
neni 3 pika 6, Senati Akademik i Universitetit, i mbledhur në datën 31.08.2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Rektorit të Universitetit "Fan S. Noli", për emërimin e Prof. as. dr. Frederik Çuçllari si nënkryetar të Senatit Akademik.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof.dr. Dhimitri Bello**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1198 prot

Korçë, më 31 / 08 / 2020

VENDIM

Nr. 393, datë 31.08.2020

PËR

**LIRIMIN NGA DETYRA TË ZËVËNDËSREKTORIT PËR MËSIMIN DHE
ZËVËNDËSREKTORIT PËR SHKENCËN DHE PROJEKTET**

Mbështetur në Statutin e Universitetit, neni 14 pika 2, Senati Akademik i Universitetit
"Fan S. Noli", Korçë, i mbledhur në datën 31.08.2020,

VENDOSI:

1. Lirimin nga detyra të zëvëndësrektorit për Mësimin, Prof.as.dr. Majlinda Bello, si dhe zëvëndësrektorit për Shkencën dhe Projektet, Dr. Erinda Papa.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT
REKTORI**

Prof.dr. Dhimitri Bello





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1199 prot

Korçë, më 31/08 / 2020

VENDIM

Nr. 394, datë 31.08.2020

PËR

**MIRATIMIN E ZËVENDËSREKTORIT PËR SHKENCËN DHE
PROJEKTET**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionit e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 40 pika 2, si dhe në Statutin e Universitetit neni 13 pika 13, si dhe neni 14 pika 2, Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, i mbledhur në datën 31.08.2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Rektorit të Universitetit "Fan S. Noli", për emërimin e Dr. Benita Stavre, si zëvendësrektor për Shkencën dhe Projektet.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof.dr. Dhimitri Bello**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1027 prot.

Korçë, më 27 / 07 / 2020

VENDIM

Nr. 327, datë 27.07.2020

PËR

**MIRATIMIN E DATAVE TË KONKURRIMIT TË TESTIT PRAKTIK PËR
PROGRAMIN E STUDIMIT "BACHELOR" NË "EDUKIM FIZIK DHE
SPORTE"**

Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, nr. 80/2015, nenin 74, Udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019 "*Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar*", si dhe në Urdhrin e përbashkët nr. 2, datë 2.7.2020 "*Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, si dhe në programet të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2020-2021*", Senati Akademik në mbledhjen e datës 27.07.2020:

VENDOSI:

1. Të miratojë datat **20-21 gusht**, si data të konkursit të testeve praktike të kandidatëve për programin e studimit "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte".
2. Datat e regjistrimit të aplikantëve për konkursin do të jenë **8-19 gusht**.
3. Raporti i pikëve të fituara në konkurrimin praktik dhe notës mesatare do të jetë 40% për notën mesatare dhe 60% për testet praktike.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI

Prof. dr. Ali Jashari





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 936 prot

Korçë, më 10 / 07 / 2020

VENDIM

Nr. 296, datë 10.07.2020

PËR
MIRATIMIN E RREGULLOREVE TË DEPARTAMENTEVE TË
FAKULTETIT TË EKONOMISË

Mbështetur në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d) si dhe në Statutin e Universitetit neni 11, pika 6, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 10.7.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloret e brendshme të departamenteve të Fakultetit të Ekonomisë si më poshtë, sipas materialeve bashkëlidhur.
 - Rregullore e brendshme e departamentit Financë-Kontabilitet
 - Rregullore e brendshme e departamentit Menaxhim
 - Rregullore e brendshme e departamentit Marketing-Turizëm
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Ali Jashari





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 937 prot

Korçë, më 10 / 07 / 2020

VENDIM

Nr. 297, datë 10.07.2020

PËR
MIRATIMIN E RREGULLOREVE TË DEPARTAMENTEVE TË
FAKULTETIT TË SHKENCAVE NATYRORE DHE HUMANE

Mbështetur në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d) si dhe në Statutin e Universitetit neni 11, pika 6, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 10.7.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloret e brendshme të departamenteve të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane si më poshtë, sipas materialeve bashkëlidhur.
 - Rregullore e brendshme e departamentit të Shkencave Sociale
 - Rregullore e brendshme e departamentit të Informatikës
 - Rregullore e brendshme e departamentit të Biologji-Kimisë
 - Rregullore e brendshme e departamentit të Infermierisë
 - Rregullore e brendshme e departamentit të Matematikës dhe Fizikës
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I SENATIT
REKTORI

Prof. dr. Ali Jashari





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 938 prot

Korçë, më 10 / 07 / 2020

VENDIM

Nr. 298, datë 10.07.2020

PËR
MIRATIMIN E RREGULLOREVE TË DEPARTAMENTEVE TË
FAKULTETIT TË BUJQËSISË

Mbështetur në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d) si dhe në Statutin e Universitetit neni 11, pika 6, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 10.7.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloret e brendshme të departamenteve të Fakultetit të Bujqësisë si më poshtë, sipas materialeve bashkëlidhur.
 - Rregullore e brendshme e departamentit të Agronomisë
 - Rregullore e brendshme e departamentit të Agrobiznesit
 - Rregullore e brendshme e departamentit Agroushqim
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Ali Jashari





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 939 prot

Korçë, më 10 / 07 / 2020

VENDIM

Nr. 299, datë 10.07.2020

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLOREVE TË DEPARTAMENTEVE TË
FAKULTETIT TË EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË**

Mbështetur në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d) si dhe në Statutin e Universitetit neni 11, pika 6, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 10.7.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloret e brendshme të departamenteve të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë si më poshtë, sipas materialeve bashkëlidhur.
 - Rregullore e brendshme e departamentit të Edukimit
 - Rregullore e brendshme e departamentit të Gjuhë-Letërsisë
 - Rregullore e brendshme e departamentit të Histori-Gjeografisë
 - Rregullore e brendshme e departamentit të Gjuhëve të Huaja
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI I SENATIT
REKTORI**
Prof. dr. Ali Jashari





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 940 prot

Korçë, më 10 / 07 / 2020

VENDIM

Nr. 300, datë 10.07.2020

PËR

MIRATIMIN E MANUALIT TË CILËSISË I UNIVERSITETIT
"FAN S. NOLI", KORÇË

Mbështetur në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma j) si dhe në Statutin e Universitetit neni 11, pika 17, dhe neni 73 pika 3, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 10.7.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë Manualin e Cilësisë së Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I SENATIT
REKTORI

Prof. dr. Ali Jashari





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 728 prot

Korçë, më 01 / 06 / 2020

VENDIM

Nr. 245, datë 01.06.2020

PËR
MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021
PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË

Mbështetur në Statutin e Universitetit neni 11, pika 20, si dhe bazuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018, pika 2.7, gërma a, Senati Akademik pasi diskutoi për propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore në lidhje me kuotat e pranimit për vitin akademik 2020-2021, për programet e studimit të ciklit të parë dhe ciklin të dytë, në mbledhjen e datës 01.06.2020


VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat e pranimit për vitin akademik 2020-2021 për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve bazuar në propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore.
